

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: :“NDËRTIM BAZAMENTE PËR URË TIP BAILY HD 30ML
,ME SEKSION 1/1,NJËSIA ADMINISTRATIVE ORENJË ,BASHKIA LIBRAZHD”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

Vlera e fondit limit: është: 8,000,309 (tetë milion e treqind e nente) lekë pa tvsh .

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrrenjas, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti Ekonomik Dhe Financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke qene lloji i procedure : E hapur e thjeshtuar, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndryshuar , ku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024** (*Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009*), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 dhe kestin perkates te maturuar per vitin 2025, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave ku ka zhvilluar apo zhvillon aktivitet . (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia,

është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49%** e vlerës së përllëgëritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit** është **jo më e vogël se 198 %** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore,
 - Aktin e kolaudimit;

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikaten e marrjes në dorezim të përkohshme ose përhershme

Shënim: Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë të bashkimit të cilët kanë përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve , prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit si dhe preventivin e ndarjs puneve ;

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Sipas përcaktimeve të pikes 5, të nenit 39, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: 5. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet...”*

Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, ku përcaktohen vlerat kufi që AK mund të përcaktojë në kriter, operatorët ekonomikë **mund të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlera kufi minimale.**

Për rrjedhojë, AK ka përcaktuar që ofertuesit duhet të kenë realizuar kontrata të ngjashme: “...**në një vlerë jo më të vogël se...**”, por pa tejkaluar vlerën maksimale të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, .:

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

2.3.2/1 Kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-A	Punime gjurmimi në tokë
2	NP-4-A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

3	NP-5-A	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NS-18-A	Punime topogjeodezike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që</i>

			respektive	përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Seksioni 1-Punime nën strukture Zëri me nr.analize 3.103/a Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ prani uji k IV shk. toke Zëri me nr.analize 3.103/a Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ prani uji k IV shk. Toke themele shpatulla ure. Zëri me nr.analize 3.158/5a 3.158/5a-Transport gure me auto deri 2 km	Niveli A	Sipas preventivit
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada,mbikal ime	Seksioni 3-Punime mbi strukture	Niveli A	Sipas preventivit
<u>Kategoria NP-5</u>	Punime nëntokësore, ura, vepra arti	Seksioni 1- -Punime nën strukture zerat nr. Analizave 3.244	Niveli A	Sipas preventivit
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike	Seksioni 1- Punime nën strukture Seksioni 2- Punime në hyrje dalje të ures	Niveli A	Sipas preventivit

2.3.2/2 Personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi Civile / Ura

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe

në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas DST, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar :

- Referuar kategorive të licencave NP-1 dhe NP-4_është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit si person përgjegjës për ndjekjen e punimeve të ndërtimit dhe siguron që ato të kryhen sipas standardeve dhe projekteve të miratuara. *Inxhinieri i Ndërtimit, është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të bazamentit të ures.*
- Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP-5, është e nevojshme prezenca e Inxhinier Gjeolog për kryerjen e analizës së terrenit dhe hartimin e raportit gjeoteknik që është i detyrueshëm për projektin
- Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NS18, është e nevojshme prezenca e Inxhinier Gjeodet/Topograf, pasi përcakton dhe monitoron matjet e terrenit dhe siguron saktësinë e punimeve topogjeodezike dhe çdo matje, pozicionim, rakordim në vendosje sipas plan-vendosjes që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri, *me qëllim realizimin e rëlevimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **25 (njëzet e pesë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, në formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën e kërkuar.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve dhe projektit teknik (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Numri prej 25 punonjës është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjesve janë marrë parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 25 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar sipas orëve të punës për cdo zë pune, volumi për ditë pune për punonjës të nevojshëm për zbatimin e projektit.

2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndertimi (Profili Transport/Infrastruktura)

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së

afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Inxhinier Ndertimi (Profili Transport/Infrastruktura) projektin hyrje-daljet e urës dhe sistemin e rrugës që lidhet me të dhe gjithashtu ben Projektim drenazhimi dhe menaxhimi i ujërave.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e *Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.
 - **1(nje)** prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise duhet te jete i certifikuar si Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.
(Për ekspertin e Mjedisit certifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
 - **1(nje)** prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për *“Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015”*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
(Për pergjegjesin e kontrollit te cilesise duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
- Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij **3 (tre)** persona specialist te certifikuar per **"Punime ne lartesi"**, te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori fitues duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 39, pika 8), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”I ndryshuar , të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 *Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: *Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“*

Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DT, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.Gjithashtu është e nevojshme për të siguruar kushte të sigurt pune për punëtorët dhe për të respektuar rregulloret e sigurisë. Gjithashtu duke iu referuar objektit të procedurës së prokurimit që katë bëjë me ndërtim bazamenti ure eshte e domosdoshme prania e specialist te certifikuar per "Punime ne lartesi".

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si më poshtë:

Teknik i mesëm ndërtimi	1 (nje)
Teknik i mesëm gjeodet/topograf	1 (një)
Karpentier	2 (dy)
Hekurkthyes	2 (dy)
Specialist për punime betoni (betonues)	1 (nje)
Eskavatorist	1 (nje)
Automakinist	1 (nje)
Shofere	2 (dy)
1 (një) Punonjes/specialist për punime në prezence uji	

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontrata e punës, e vlefshme;

- Të figurojë në Listpagesat e subjektit për periudhën e kërkuar (tre muja nga data e njoftimit të kontratës).
- Dokument (diplomë/certifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”.
- Per tekniket duhet të deklarohen dhe paraqitet diplome e shkolles se mesme teknike ndersa Për punonjesit Eskavatorist/Automakinist/Buldozerist te paraqiten leje drejtimi, certificate e aftesise profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR).

Per te gjithë stafin teknik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë: emrin dhe mbiemrin; profesionin/profilin e punes; numrin e kontratës individuale të punës dhe afatin e vlefshmerise se saj; numrin e diplomës/certifikatës së arsimit profesional/Patentës Manovrimin nga DPSHTRR dhe afatin e vlefshmerise se saj si edhe autoritetin leshues te saj shoqeruar me niptin perkates kur keto autoritete jane private.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit)

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre.

Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

-1 (një) Teknik i mesëm ndërtimi është i nevojshem për ndjekjen e punimeve në terren. Ndhmon në mbikëqyrje dhe zbatim në kantier. Harton ditarin e punimeve dhe kontrollon cilësinë e punimeve të betonit.

-1 (një) Teknik i mesëm gjeodet/topograf, është i nevojshem për realizimin e piketave, trasime dhe kontrollin e niveleve gjatë gjithë fazës së ndërtimit dhe përcaktimin e vijave të projektit te bazamentit te ures .

2 (dy) karpentier janë të nevojshëm për ndërtimin e kallëpeve për strukturat e betonit (C20/25).Përgatisin kallëpin për themele, mure mbajtëse apo mbrojtëse.

2 (dy) hekurkthyes janë të nevojshëm për punimet e hekurit ,prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike

1 (nje) punonjës specialist betoni (betonues), kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike

1(një) ekskavatorist ,kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike. Përdorimi i mjeteve të renda si eskavator, fadrome, etj.

1(një) automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike. Përdorimi i makinave teknologjike si autobotin, etj.

2(dy) punonjes shofer per kamion ,kamionçine

1 (një) Punonjes/specialist per punime ne prezence uji është i nevojshëm në projektet ku ujërat nëntokësore ose sipërfaqësore përbëjnë rrezik ose ndikim në procesin ndërtimor.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamionçinë deri 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion me vinç të integruar	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Autopompë betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Rimorkiator për transport mjeteve të rënda	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 deri 12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Eskavatorë me zinxhir me krah minimal 15m	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Dumper kantieri	Pronësi ose me qira	Copë 1
15	Minieskavatorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Pompë thithëse uji	në pronësi ose me qira	Copë 2

17	Betoniere kantjeri 500L	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Aparat topografik GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Total station	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
21	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
22	Tabela sinjalizuese kantjeri	në pronësi ose me qira	Copë 10
23	Kaska/kokore	në pronësi ose me qira	Copë 25
24	Jeleke kantjeri	në pronësi ose me qira	Copë 25
25	Komplet i ndihmes shpejte	në pronësi ose me qira	Copë 3

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:*

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;
Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për impiantin e betonit dhe nyjen e inerteve duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e betonit dhe nyjen e inerteve mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodit III.1.B lëshuar nga QKL.
- Për mjetet që transportojnë mjete të rënda duhet të paraqitet certifikata përkatëse e lëshuar nga institucioni kompetent.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime

dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.8 Ne përputhje me kërkesat dhe specifikat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne specifikimet teknike dhe projekt preventiv, për materialet:

a. Hekur ndertimor;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.
- **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.
- Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me **ISO 9001** (*Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë*)/ ekuivalente dhe e vlefshme / ose të pajisur me Çertifikatë konformiteti.

Për plotësimin e pikës 2.3.9, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur Autorizimet/Kontratat e furnizimit përkatëse si dhe certifikatat e sipër kërkuara për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 8,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001: 2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

- Liçence leshuar nga QKL me kod III-2-B “Per grumbullim dhe transportim mbetjesh jo te rrezikshme qe dalin nga ndertimet”
- Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Kodin III.2.A(1+2) "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis"-Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 8,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një **laborator testimi të betonit**, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve **SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 8,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 8,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivi/ dhe grafiku për procedurën respektive janë hartuar nga subjekti i licensuar që ka hartuar edhe projekt preventivin përkatës të zbatimit duke qenë elemente perberes të tij dhe argumentimi i nr. të punonjeseve të verifikuara nga specialistet e fushës .

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të VKM nr 216 datë 13.04.2023. (Bashkengjitur dosjes proceverbali i struktures të posaçme, për përlogaritjen e fondit limit)

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve /Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialistet e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Njësia e prokurimit